



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar

Numër 13

D H J E T O R 2 0 2 2

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve për Inflacionin

Numër 13

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar	4
Hyrje	4
Përmbledhja e rezultateve	4
Kutia 1. Metodologjia	7
Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi.....	8
Kreditë ndaj ndërmarrjeve	8
Standardet kreditore	8
Kushtet dhe rregullat.....	9
Kërkesa për kredi.....	10
Kreditë ndaj ekonomive familjare	11
Standardet kreditore	11
Kushtet dhe rregullat.....	11
Kërkesa për kredi.....	12
Financimi	13
Rezultatet e pyetjeve të fokusuara	14
Pritjet për Inflacionin	16
Metodologjia	16
Përmbledhja e rezultateve	17

Anketa e Kreditimit Bankar

Hyrje¹

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi, do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim, si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2022, dhe pritjet e bankave për dinamikat në kreditim për tremujorin e katërt të vitit 2022.

Përveç pyetjeve standarde, kjo anketë është plotësuar me gjashtë pyetje shtesë në përpjekje për të adresuar ndikimin e presioneve inflacioniste në dinamikat dhe politikat e kreditimit. Gjithashtu, bankat elaboruan mbi ndikimin indirekt të inflacionit në kostot e financimit të sektorit bankar dhe ndikimin në rrezikun kreditor. Tutje, në këto pyetje u elaboruan edhe pritjet e bankave mbi krizën energjetike dhe masat e mundshme për menaxhimin e këtij rreziku. Për më tepër, një nga pyetjet zbërthen ofertën dhe kërkesën kreditore sipas sektorëve ekonomik.

Përmbledhja e rezultateve²

Presionet inflacioniste në vend dhe në nivel global vazhduan të përcaktojnë sjelljen e agjentëve kryesor në treg. Rreziqet e rritura kundrejt fuqisë blerëse të konsumatorëve rezultojnë të kenë ndikuar ofertën kreditore, ndërkohë që tkurrja e vlerës së të ardhurave të disponueshme rezulton të ketë ndikuar zbehur kërkesën për kredi në tremujorin e tretë të vitit 2022.

Rritja vjetore e stokut të gjithsej kredive vazhdoi me ritëm të përsheptuar deri në tremujorin e tretë të vitit 2022. Kreditë e reja krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak shënuan po ashtu rritje të përsheptuar, ndërsa në krahasim me tremujorin paraprak shënuan rënie. Këto dinamika të kreditimit u ndikuan në masë më të madhe nga kërkesa kreditore, pasi që oferta kreditore u shtrëngua deri në një masë. Ndërsa për dallim me tremujorin aktual, bankat për TM4 2022 presin që kërkesa për kredi të shënoi rritje, përderisa oferta kreditore të mbetet kryesisht e pandryshuar.

Sipas bankave, dinamika e kreditimit të ndërmarrjeve gjatë këtij tremujori u ndikua në masë më të madhe nga kërkesa e rritur kreditore nga ndërmarrjet e mëdha, përderisa oferta kreditore u shtrëngua në nivel të ulët. Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se standarde kreditore të shtrënguara u aplikuan gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi në tremujorin e tretë të vitit 2022. Përgjigjet e bankave rezultuan me indeks negativ të ulët për ndryshimet në standardet kreditore për të dy kategoritë e ndërmarrjeve (tabela 1). Në kontekst të pritjeve për ngadalësim ekonomik, rreziqet e lidhura me perspektivën jo të mirë të tregut në vend, si dhe rënia e tolerancës ndaj rrezikut patën kontributin negativ kryesor në standardet kreditore. Përderisa, faktori i vetëm me ndikim deri në një masë pozitiv në standardet kreditore ishte qasja e favorshme në financim e bankave amë. Njëkohësisht, bankat ulën lehtësisht normën e aprovimit të kredive për ndërmarrjet, kryesisht për NVM-të. Për tremujorin e katërt të vitit 2022, bankat pritjet të aplikojnë

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

² Pyetësori dhe seria kohore e rezultateve të AKB-së janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.

ndryshime marginale pozitive në standardet kreditore, kryesisht për NVM-të (grafik 1). Mbështetja nga FKGK dhe presioni i konkurrencës ishin faktorët që ndikuan këto lëvizje në standardet kreditore. Njëkohësisht, norma e aprovimit të kredive për NVM-të pritet të ketë rritje gjatë tremujorit të ardhshëm.

Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u shtrënguan deri në një masë. Kushte dhe rregulla të shtrënguara u aplikuan për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, kryesisht përmes uljes së normës së interesit, ndërsa për ndërmarrjet e mëdha u aplikua edhe kufizim në shumën e kredive të aprovuara. Përderisa, lehtësim edhe pse në nivel të ulët u aplikua për kërkesat në kolateral dhe maturitet të kredive për të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Faktorët që ndikuan në shtrëngimin e kushteve dhe rregullave ishin perspektiva e pasigurtë e tregut vendor dhe toleranca e ulët ndaj rrezikut, përderisa qasja e favorshme në financim e bankës amë dhe mbështetja nga FKGK përbëjnë faktorët me kontribut në lehtësim të kushteve dhe rregullave. Në tremujorin e ardhshëm, bankat pritet të aplikojnë kushte dhe rregulla të lehtësuara mirëpo në nivel të ulët për të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Kushtet dhe rregullat e lehtësuara pritet të aplikohen në normat e interesit dhe në një nivel më të ulët në shumën e aprovuar të kredive dhe kërkesat për kolateral. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e ndërmarrjeve pritet të nxiten nga mbështetja nga FKGK, qasja e favorshme në financim të brendshëm (depozitat), si dhe nga cilësia e mirë e portfolios kreditore.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022, kishte rritje marginale të kërkesës për kredi bankare nga ndërmarrjet, nivel më i ulët në krahasim me tremujorin paraprak. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet rezultoi të jetë e përafërt me pritjet e bankave për TM3 2022, të shprehura në anketën e kaluar (TM2 2022). Indeksi i gjeneruar për kërkesën për kredi nga NVM-të u ndikua nga përgjigjet e dy bankave me peshë të madhe dhe rëndësi sistemike të cilat deklaruan rënie të kërkesës deri në një masë, dhe nga përgjigjja e pesë bankave, prej tyre një me rëndësi sistemike, të cilat deklaruan rritje të kërkesës. Kjo rritje e kërkesës, sipas deklaratave të bankave, u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues. Bankat presin rritje dukshëm më të lartë të kërkesës për kredi në tremujorin e ardhshëm, kryesisht për NVM-të. Kërkesë e rritur pritet për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, si dhe për investimet fikse.

Stoku i kredive për ekonomitë familjare shënoi rritje të konsiderueshme vjetore në shtator 2022, mirëpo kreditë e reja për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të tretë 2022 kishin rënie në krahasim me tremujorin paraprak, ndërsa rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ngjashëm me kreditimin e ndërmarrjeve, kërkesa kreditore ishte nxitësi kryesor i dinamikave të aktivitetit kreditues për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese, përderisa oferta kreditore u shtrëngua. Standardet kreditore në tremujorin aktual, në përgjithësi, rezultojnë të jenë të përafërta me pritjet e bankave të shprehura në anketën e kaluar. Standardet kreditore u shtrënguan kryesisht për kreditë për blerjen e shtëpive, përderisa për kreditë konsumuese ato mbetën pothuajse të pandryshuara. Këto shtrëngime u ndikuan kryesisht nga perspektiva jo e mirë e tregut vendor, toleranca e ulët ndaj rrezikut, si dhe në nivel më të ulët perspektiva jo e mirë e tregut të patundshmërive. Në tremujorin e katërt 2022, bankat nuk presin lëvizje të rëndësishme në standardet kreditore për ekonomitë familjare. Saktësisht, pritet lehtësim marginal i standardeve kreditore për kreditë konsumuese (tabela 1).

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht u shtrënguan. Rezultatet e gjeneruara kryesisht reflektojnë shtrëngime në një nivel më të lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Saktësisht, bankat aplikuan shtrëngime në kushtet dhe rregullat për kredi përmes rritjes së normës së interesit dhe rritjes së ngarkesave tjera përveç interesit. Ndërsa, lehtësim në nivel të ulët u aplikua në kërkesat për kolateral. Faktorët kryesor që ndikuan negativisht kushtet dhe rregullat për ekonomitë familjare ishin perspektiva jo e favorshme e tregut në vend në përgjithësi, dhe e tregut të patundshmërive në veçanti. Në kushte të rritjes së çmimeve në vend edhe rënia e besueshmërisë ndaj klientëve, ishte faktor që kontribuoi negativisht.

Përderisa, qasja e favorshme në financim e bankave amë kontribuoi në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të aplikuara nga bankat gjatë TM3 2022. Për tremujorin e katërt të vitit 2022, bankat në përgjithësi presin ndryshime të vogla në kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare. Shtërngimi i kushteve dhe rregullave pritet të jetë deri në një masë i përafërt për të dy kategoritë e kredive. Kryesisht, kushtet dhe rregullat për të dy kategoritë pritet të shtërngohen përmes rritjes së normës së interesit, edhe pse në nivel më të ulët se sa vlerat për TM3 2022, dhe të lehtësohen në nivel të ulët kërkesat për kolateral.

Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare në përgjithësi ka shënuar rritje marginale gjatë tremujorit të tretë 2022. Mirëpo, nëse e zërthejmë kërkesën kreditore sipas llojeve të kredive për ekonomitë familjare, rezultojnë që kërkesa për kredi konsumuese shënoi rritje deri në një masë, përderisa kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive shënoi rënie. Këto dinamika në kërkesën për kredi u reflektuan edhe në faktorët që kontribuojnë në kahjen e saj. Konkretisht, nevoja për financim të konsumit ishte faktor që kontribuoi pozitivisht, përderisa përkeqësimi i perspektivës në tregun e patundshmërive ishte faktor që kontribuoi negativisht kërkesën kreditore. Në tremujorin e katërt të vitit 2022, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, në nivel të përafërt për të dy llojet e kredive. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat presin që perspektiva e tregut të patundshmërive dhe nevoja për financimin e shpenzimeve për konsum të ndikojnë deri në një masë kërkesën për kredi gjatë tremujorit të ardhshëm.

Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM3 2022	TM4 2022 (pritjet)	TM3 2022	TM4 2022 (pritjet)
Ndërmarrjet				
NVM				
Ndërmarrjet e mëdha				
Ekonomitë familjare				
Kredi për blerjen e shtëpive				
Kredi konsumuese				

Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)
 Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)
 Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)
 Shtërngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)
 Shtërngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)

Burimi: BQK.

Monitorimi prudent i performancës financiare të klientëve ndihmoi në përmirësimin apo mirëmbajtjen e performancës së ri-pagimit të kredive. Rrjedhimisht, bankat deklaruan përmirësim të cilësisë së portfolios kreditore, pasi që indeksi i përgjithshëm i përgjigjeve edhe këtë tremujor qëndroi negativ dhe në nivel më të lartë në krahasim me tremujorin e kaluar, e që nënkupton rënie të raportit në mes kredive jo-performuese dhe gjithsej kredive. Ky përmirësim ishte më i lartë për sektorin e ekonomive familjare se sa për sektorin e ndërmarrjeve. Përderisa, për tremujorin e ardhshëm indeksi i gjeneruar pritet të ndërroj kahje dhe të kalojë në pozitiv, duke reflektuar pritjet e bankave për përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore. Këto pritje kryesisht u ndikuan nga dinamikat e rritjes së çmimeve në vend, e me të edhe nga rënia e fuqisë blerëse të klientëve. Më saktësisht, bankat presin përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditore të ekonomive familjare në nivel më të lartë se sa për ndërmarrjet.

Bankat raportuan rritje të theksuar të qasjes në financim gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022, duke tejkaluar nivelin në tremujorin e kaluar (TM2 2022). Rezultati i agreguar i përgjigjeve të bankave u ndikua nga përgjigjet e tetë bankave të cilat deklaruan rritje të financimit, dhe një banke me rëndësi sistemike e cila deklaroi rënie deri në një masë të qasjes në financim. Financimi u rrit nga pothuajse të gjitha burimet e financimit. Depozitat e ekonomive familjare kishin rritjen më të madhe, pasuar nga depozitat e ndërmarrjeve. Financimi nga bankat amë po ashtu kontribuoi në rritje të financimit edhe pse në nivel më të ulët krahasuar me tremujorin paraprak, i deklaruar nga vetëm dy banka. Sipas maturitetit, depozitat afatgjata ishin burimi i financim me rritjen më të lartë gjatë këtij tremujori. Gjatë tremujorit të ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje të qasjes në financim në një nivel më të ulët se sa ai i tremujorit aktual. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të prijë rritjen e financimit të sektorit bankar, pasuar nga financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare. Sa i përket maturitetit të financimit, bankat presin që edhe këtë tremujor rritjen e financimit ta dominojnë depozitat me maturitet afatgjatë. Dinamikë e nxitur nga ofertat e favorshme për tërheqjen e depozitave të aplikuara nga sektori bankar.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar

Pyetësi i AKB është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKB është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrë më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKB përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKB mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë dhjetë nga njëmbëdhjetë bankat që operojnë në Kosovë³. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.8 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku

³ Banka e cila nuk është përfshirë në anketë është Komercialna Banka e cila ka aktivitet kreditor të limituar.

bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se sa ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë.

Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.


Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi

Kreditë ndaj ndërmarrjeve

Standardet kreditore

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022, rezultati për standardet kreditore (udhëzimet e brendshme të bankave apo kriteret për aprovimin e kredive) të aplikuara për ndërmarrjet në përgjithësi tregon për standarde kreditore të shtrënguara deri në një masë. Përderisa, në anketën e kaluar (TM2 2022), bankat kishin deklaruar se presin standarde kreditore kryesisht të pandryshuara (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, bankat deklaruan indeks negativ prej 0.14 për ndryshimet në standardet kreditore për NVM-të dhe 0.12 për ndërmarrjet e mëdha. Saktësisht, rezultati për NVM-të u ndikua nga përgjigjet e tre bankave pjesëmarrëse, dy prej tyre me rëndësi sistematike, të cilat deklaruan shtrëngim deri në një masë të standardeve kreditore për ndërmarrjet e mëdha. Gjithashtu, për ndërmarrjet e mëdha dy banka deklaruan shtrëngim deri në një masë. Faktorët kryesor që ndikuan negativisht standardet kreditore ishin rënia e tolerancës ndaj rrezikut dhe rreziku i rritur në perspektivën e tregut të brendshëm me indeks negativ prej 0.21 dhe 0.14, respektivisht, duke reflektuar ndikimin e rritjes së çmimeve në vend. Përderisa, faktori i vetëm me indeks deri në një masë më të lartë që ndikoi pozitivisht, duke i ofruar siguri sektorit bankar, ishte qasja e favorshme në financim e bankave amë me indeks pozitiv prej 0.14.

Norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet rezulton të jetë shtrënguar marginalisht. Saktësisht, ky rezultat reflekton përgjigjet e dy bankave me peshë të madhe dhe rëndësi sistematike, të cilat i


neutralizuan përgjigjet e tre bankave tjera që deklaruan rritje deri në një masë të normës së aprovimit të kredive. Norma e aprovimit të kredive për NVM- u ndikua nga përgjigjet e gjashtë bankave pjesëmarrëse (prej tyre dy banka me rëndësi sistematike) të cilat deklaruan rënie, përderisa katër nga bankat deklaruan rritje të normës së aprovimit (prej tyre një bankë me rëndësi sistematike). Përderisa, për ndërmarrjet e mëdha norma e aprovimit të kredive nuk kishte lëvizje të rëndësishme në këtë tremujor.

Standardet kreditore në përgjithësi pritet të kenë ndryshime marginale pozitive në tremujorin e ardhshëm. Konkretisht, lehtësim pritet të kenë standardet kreditore për NVM-të, ndikuar nga pritjet e dy bankave me rëndësi sistematike. Mbështetja nga FKGK dhe presioni i konkurrencës ishin faktorët që ndikuan pozitivisht standardet kreditore. Njëkohësisht, norma e aprovimit të kredive pritet të ketë rritje gjatë tremujorit të ardhshëm, kryesisht për NVM-të.

Kushtet dhe rregullat

Në tremujorin e tretë të 2022, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet dhe rregullat përkatëse të një kontrate të caktuar për kredi) u shtrënguan edhe pse në nivel të ulët (grafiku 2). Sektori bankar aplikoi shtrëngim të përafërt të kushteve dhe rregullave për kreditë e reja si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Konkretisht, për të dy kategoritë e ndërmarrjeve shtrëngim deri në një masë kishte në normën e interesit të aplikuar (indeks negativ prej 0.18 për NVM-të dhe 0.13 për ndërmarrjet e mëdha), ndërsa për ndërmarrjet e mëdha u aplikua edhe kufizim në shumë e kredive të aprovuara (indeks negativ prej 0.09). Lehtësim në nivel të ulët u aplikua për kërkesat në kolateral dhe maturitet të kredive për të dy kategoritë e ndërmarrjeve.

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Burimi: BQK.

Faktorët me kontributin kryesor në shtrëngimin e kushteve dhe rregullave këtë tremujor ishin pa siguria e perspektivës së tregut vendor dhe toleranca e ulët ndaj rrezikut me indeks negativ 0.13 dhe 0.20, respektivisht. Ndërsa, faktorët që ndikuan pozitivisht në kushtet dhe rregullat e aplikuara ishin qasja e favorshme në financim e bankës amë dhe mbështetja nga FKGK me indeks pozitiv prej 0.15 dhe 0.16, respektivisht.

Bankat gjatë tremujorit të ardhshëm, pritet të aplikojnë kushte dhe rregulla të lehtësuara mirëpo në nivel të ulët. Në këtë kontekst, bankat deklaruan që presin lehtësim të përafërt si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Tre banka, prej tyre dy me rëndësi sistematike e peshë të lartë në kreditim, presin rënie të normave të interesit për kredi deri në një masë, përderisa banka e tretë deklaroi se pret rritje të normave të interesit për NVM-të, gjë që gjeneroi një indeks të ulët pozitiv prej 0.11 për NVM-të dhe 0.15 për ndërmarrjet e mëdha. Kërkesa më të ulëta për kolateral pritet të ketë për të dy kategoritë e ndërmarrjeve me indeks pozitiv marginal prej 0.07, ndërsa shumica e aprovuar për kreditë e reja pritet të rritet vetëm për NVM-të. Këto pritje bankat i bazuan kryesisht në

mbështetjen nga FKGK, qasjen e favorshme në financim të brendshëm (depozitat), si dhe cilësinë e mirë të portfolios kreditore.


Kërkesa për kredi

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022, kërkesa për kredi nga ana e ndërmarrjeve shënoi rritje marginale, nivel më i ulët krahasuar me TM2 2022. Kërkesa për kredi rezultoi të jetë e përafërt me pritjet e bankave për TM3 2022 të shprehura në anketën e kaluar (TM2 2022) (grafiku 3). Kërkesa për kredi nga NVM-të kishte indeks negativ marginal prej 0.04, përderisa kërkesa kreditore nga ndërmarrjet e mëdha gjeneroi indeks pozitiv prej 0.12. Indeksi i gjeneruar për kërkesën për kredi nga NVM-të u ndikua nga përgjigjet e dy bankave me peshë të madhe dhe rëndësi sistemike të cilat deklaruan rënie të kërkesës deri në një masë, dhe nga përgjigjja e pesë bankave, prej tyre një me rëndësi sistemike, të cilat deklaruan rritje të kërkesës.

Sipas rezultateve të anketës, ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet u ndikuan kryesisht nga kërkesa për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues me indeks marginal pozitiv prej 0.06, ndërsa kërkesat për financimin e investimeve fikse mbetën kryesisht të pandryshuara. Rezultati i faktorëve kontribuues në kërkesën për kredi u ndikua nga përgjigjet e pesë bankave, të cilat deklaruan rritje të kërkesës për financim të inventarëve dhe kapitalit punues dhe katër bankave që deklaruan rritje të kërkesës për financim të investimeve fikse. Sidoqoftë, dy banka me peshë të madhe në kreditim deklaruan se për të dy faktorët e lartpërmendur kishte kërkesë deri në një masë më të ulët, gjë që edhe rezultoi në indekse marginale. Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ndërmarrjet nuk kishte ndonjë ndryshim të rëndësishëm gjatë TM3 2022.

Sipas anketës, gjatë TM3 2022 raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve ndaj gjithsej kredive është në rënie me indeks negativ të ulët prej 0.11, sidoqoftë ky rezultat paraqet përmirësim krahasuar me rezultatin në anketën e kaluar ku përgjigjet e bankave gjeneruan indeks negativ marginal prej 0.04 të këtij raporti. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e shtatë bankave, ku prej tyre tre banka me rëndësi sistemike deklaruan rënie të kredive jo-performuese përderisa katër banka tjera, ndër to një bankë me rëndësi sistemike, deklaruan rritje të tyre.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Bankat presin rritje në nivel dukshëm më të lartë të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet gjatë tremujorit të ardhshëm. Këto pritje u ndikuan nga përgjigjet e shtatë bankave, prej tyre tre me rëndësi sistemike, të cilat presin rritje deri në një masë të kërkesës për kredi. Rrjedhimisht, këto përgjigje rezultuan në një indeks pozitiv më të lartë nëse e krahasojmë me kërkesën aktuale për kredi, saktësisht rezultoi indeks pozitiv 0.32 për TM4 2022. Kërkesa e rritur për kredi pritet të financojnë investimet në kapital punues dhe inventarë, si dhe investimet fikse. Njëkohësisht, bankat nuk presin ndryshime të rëndësishme sa i përket cilësisë së aplikacioneve të pranuar për kredi.

Gjatë tremujorit të ardhshëm bankat presin që raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ndërmarrjet, të ndërroj kahje dhe të kaloj në indeks pozitiv prej 0.11, duke reflektuar pritjet e bankave për përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditorë. Këto pritje kryesisht u ndikuan nga dinamikat e rritjes së çmimeve në vend, e me të edhe rënia e fuqisë blerëse të klientëve. Tre banka, ku dy prej tyre me rëndësi sistemike, deklaruan pritje për rritje të kredive jo-performuese të ndërmarrjeve, ndërsa një bankë po ashtu me rëndësi sistemike deklaroi pritjet për rënie të tyre.


Kreditë ndaj ekonomive familjare

Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonominë familjare gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022 përgjithësisht u shtrënguan. Shtrëngimi kryesisht u aplikua në standardet kreditore për kreditë për blerjen e shtëpive me indeks negativ prej 0.14, ndërkohë që standardet kreditore për kreditë konsumuese mbetën pothuajse të pandryshuara. Rezultati kryesisht reflekton përgjigjet e dy bankave me rëndësi sistemike të cila shtrënguan standardet kreditore, si dhe dy bankave tjera po ashtu me rëndësi sistemike të cilat lehtësuan standardet kreditore. Pritjet për tremujorin e tretë 2022, të deklaruara nga bankat në anketën e kaluar, rezultuan të përafërta me vlerat aktuale (grafiku 4). Faktorë që kontribuan negativisht në standardet kreditore ishin perspektiva jo e mirë e tregut vendor me indeks negativ prej 0.13, toleranca e ulët ndaj rrezikut me indeks negativ prej 0.11, si dhe perspektiva jo e mirë e tregut të patundshmërive me indeks negativ të ulët prej 0.09.

Bankat deklaruan të kenë rritur normën e aprovimit të kredive për ekonominë familjare, vetëm për kreditë konsumuese, me indeks pozitiv të ulët prej 0.10, përderisa norma e aprovimit të kredive për kreditë për blerjen e shtëpive rezultoi me indeks negativ marginal prej 0.06.

Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonominë familjare dhe faktorët që kontribuan




Në tremujorin e katërt 2022, bankat nuk presin lëvizje të rëndësishme në standardet kreditore. Saktësisht, pritet lehtësim marginal i standardeve kreditore për kreditë konsumuese. Në linjë me këto pritje, edhe faktorët e listuar në anketë gjeneruan indekse marginale. Ndërsa, bankat presin rritje të nivelit të aprovimit të kredive për kreditë konsumuese në nivel të ulët. Konkretisht, pritet rritje e normave të aprovimit të kredive e njëjtë për të dy kategoritë e kredive me indeks pozitiv prej 0.09.

Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonominë familjare përgjithësisht u shtrënguan deri në një masë. Rezultatet e gjeneruara kryesisht reflektojnë shtrëngime në një nivel më të lartë për kreditë

për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Saktësisht, për kreditë për blerjen e shtëpive bankat aplikuan norma më të larta të interesit (indeks negativ prej 0.31) dhe ngarkesa tjera përveç interesit më të larta (indeks negativ prej 0.17), përderisa lehtësuan maturitetin dhe kërkesën për kolateral (indeks pozitiv prej 0.11 dhe 0.10, respektivisht). Për kreditë konsumuese, bankat po ashtu aplikuan normë më të lartë të interesit (indeks negativ prej 0.21) dhe ngarkesa tjera përveç interesit më të larta (indeks negativ 0.17), ndërsa lehtësuan kërkesat për kolateral në nivel të ulët (indeks pozitiv prej 0.10) (grafiku 5).

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Sipas bankave, faktorët kryesor që ndikuan negativisht kushtet dhe rregullat për ekonomitë familjare ishin perspektiva jo e favorshme në tregut në vend në përgjithësi, dhe në tregun e patundshmërive, në veçanti. Në kushte të rritjes së çmimeve në vend edhe rënia e besueshmërisë ndaj klientëve, ishte faktor që kontribuoi negativisht. Përderisa, qasja e favorshme në financim e bankave amë kontribuoi në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të aplikuara nga bankat gjatë TM3 2022.

Për tremujorin e katërt të vitit 2022, bankat në përgjithësi presin shtrëngime marginale në kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare. Shtrëngimi i kushteve dhe rregullave pritet të jetë deri në një masë i përafërt për të dy kategoritë e kredive. Kryesisht, kushtet dhe rregullat për të dy kategoritë pritet të shtrëngohen përmes rritjes së normës së interesit, edhe pse në nivel më të ulët se sa vlerat për TM3 2022, ndërsa pritet të lehtësohen në nivel të ulët kërkesat për kolateral. Pas indeksimit të përgjigjeve të bankave rezulton që kryesisht faktorët e listuar në anketë nuk pritet të ndryshojnë gjatë tremujorit të ardhshëm, përveç rritjes së presionit të konkurrencës e cila pritet të ketë kontribut pozitiv në kushtet dhe rregullat për ekonomitë familjare.

Kërkesa për kredi


Pas gjenerimit të rezultateve për kërkesën kreditore në këtë tremujor, rezulton që kërkesa kreditore në përgjithësi ka shënuar rritje marginale. Mirëpo, nëse e zbërthejmë kërkesën kreditore sipas llojeve të kredive për ekonomitë familjare, rezulton që kërkesa për kredi konsumuese shënoi rritje me indeks pozitiv prej 0.20, përderisa kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive shënoi rënie me indeks negativ prej 0.14. Saktësisht, pesë banka, prej tyre dy me rëndësi sistemike raportuan për rritje të kërkesës për kredi konsumuese. Ndërsa, tre banka, prej tyre dy me rëndësi sistemike, deklaruan rënie të kërkesës për kredi për blerjen e shtëpive kundrejt dy bankave, një nga to me rëndësi sistemike, të cilat deklaruan rritje të kërkesës për të njëjtat. Nëse krahasojmë rezultatet aktuale të kërkesës për kredi me pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar për të njëjtën periudhë, niveli aktual i rritjes së kërkesës është më i ulët, ndikuar nga vlera aktuale e kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive e cila nuk ishte pritur nga bankat (grafiku 6).

Këto dinamika në kërkesën për kredi u reflektuan edhe në faktorët që kontribuojnë në kahjen e saj. Konkretisht, nevoja për financim të shpenzimeve të konsumit ishte faktor që kontribuoi pozitivisht

(indeks pozitiv 0.11), përderisa përkeqësimi i perspektivës në tregun e patundshmërive ishte faktor që kontribuoi negativisht (indeks negativ 0.11). Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare për kreditë për blerjen e shtëpive gjatë këtij tremujori rezultoi të jetë përkeqësuar me indeks negativ marginal prej 0.08, përderisa cilësia e aplikacioneve për kredi konsumuese mbeti kryesisht e pandryshuar.

Sa i përket cilësisë së portfolios kreditore për ekonomitë familjare, bankat deklaruan përmirësim me indeks negativ 0.25, duke reflektuar përgjigjet e katër bankave me rëndësi sistemike për rënie të raportit të kredive jo-performuese dhe dy banka të cilat deklaruan rritje të këtij raporti.

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Në tremujorin e katërt të vitit 2022, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, për të dy llojet e kredive në nivel të përafërt. Pritjet për rritje të kërkesës për kredi në përgjithësi u ndikuan nga përgjigjet e gjashtë bankave (dy prej tyre me rëndësi sistemike) e që rezultoi me indeks pozitiv prej 0.23. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat presin që nevoja për financimin e shpenzimeve për konsum dhe perspektiva e tregut të patundshmërive të ndikojnë deri në një masë rritjen e kërkesës për kredi gjatë tremujorit të ardhshëm. Bankat deklaruan se presin përmirësim edhe pse në nivel të ulët në cilësinë e aplikacioneve të pranuar për kredi, kryesisht për kreditë konsumuese.

Sa i përket cilësisë së portfolios kreditore gjatë TM4 2022, bankat presin që cilësia e portfolios kreditore e ekonomive familjare të përkeqësohet, bazuar në ndërrimin e kahjes së indeksit nga negativ në pozitiv krahasuar me tremujorin aktual. Saktësisht, pritjet e bankave për raportin e kredive jo-performuese rezultuan në indeks pozitiv 0.18, deklaruar nga pesë banka (dy prej tyre me rëndësi sistemike) të cilat presin rritje të këtij raporti dhe një bankë me rëndësi sistemike e cila pret rënie të të njëjtit.

Financimi


Bankat raportuan rritje të theksuar të qasjes në financim gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022. Rezultati i agreguar i përgjigjeve të bankave u ndikua nga përgjigjet e tetë bankave të cilat deklaruan rritje të financimit, ku prej tyre një bankë me rëndësi sistemike deklaroi rritje të konsiderueshme të qasjes në financim. Përderisa, vetëm një nga bankat, po ashtu me rëndësi sistemike, deklaroi rënie deri në një masë të financimi. Në rritje kontribuan pothuajse të gjitha burimet e financimit për sektorin bankar.

Bazuar në rezultatin e agreguar të përgjigjeve, gjatë këtij tremujori gjithsej financimi shënoi rritje pothuajse dyfish më të lartë në krahasim me tremujorin e kaluar. Depozitat e ekonomive familjare gjeneruan një indeks pozitiv prej 0.40 (indeks pozitiv prej 0.24 në TM2 2022). Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e nëntë nga gjithsej dhjetë bankave pjesëmarrëse në anketë, ku tetë banka deklaruan rritje të depozitave nga ekonomitë familjare dhe një deklaroi rënie deri në një masë. Përderisa,

financimi nga depozitat e ndërmarrjeve krahasuar me tremujorin paraprak u rrit dukshëm me indeks pozitiv 0.34 (indeks pozitiv prej 0.08 në TM2 2022), duke reflektuar përgjigjet e tetë bankave pjesëmarrëse, shtatë banka deklaruan rritje (një bankë me rëndësi sistemike deklaroi rritje të konsiderueshme), ndërsa një bankë deklaroi rënie të financimit nga kjo kategori. Financimi nga bankat amë po ashtu kontribuoi në rritje të financimit edhe pse në nivel më të ulët krahasuar me tremujorin paraprak dhe i deklaruar nga vetëm dy banka, saktësisht me indeks pozitiv 0.10 nga 0.24 sa ishte në TM2 2022. Ndërsa, financimi nga institucionet ndërkombëtare financiare shënoi rënie marginale, e deklaruar nga vetëm një bankë me rëndësi sistemike me indeks negativ prej 0.07 (grafiku 7). Për dallim nga tremujori paraprak, në këtë tremujor dominoj financimi me maturim afatgjatë. Konkretisht, depozitat afatgjata gjeneruan indeks pozitiv prej 0.35, ndërsa ato afatshkurtra gjeneruan indeks pozitiv prej 0.27.

Për tremujorin e ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje të qasjes në financim në një nivel më të ulët se sa ai i tremujorit aktual me indeks pozitiv prej 0.38. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të prijë rritjen e financimit të sektorit bankar me indeks pozitiv prej 0.38, pasuar nga financimi nga institucionet financiare ndërkombëtare me indeks pozitiv prej 0.17. Sa i përket maturitetit të financimit, bankat presin që edhe këtë tremujor rritjen e financimit ta dominojnë depozitat me maturitet afatgjatë me indeks pozitiv 0.33, ndërsa financimi me maturitet afatshkurtër pritet të rritet me indeks pozitiv prej 0.19 (grafiku 7).

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



Burimi: BQK.

* Vlera e pritur

Rezultatet e pyetjeve të fokusuara

Pyetësi i anketës për tremujorin e tretë të vitit 2022 është plotësuar me gjashtë pyetje shtesë në përpjekje për të adresuar ndikimin e presioneve inflacioniste në dinamikat dhe politikat e kreditimit. Gjithashtu, bankat elaboruan edhe mbi ndikimin indirekt të inflacionit në kostot e financimit të sektorit bankar dhe ndikimin në rrezikun kreditor. Tutje, në këto pyetje u elaboruan edhe pritjet e bankave mbi krizën energjetike dhe masat e mundshme për menaxhimin e këtij rreziku. Për më tepër, një nga pyetjet zbërthen ofertën dhe kërkesën kreditore sipas sektorëve ekonomik.

Çmimet në vend dhe globalisht janë në rritje qysh prej gjysmës së dytë të vitit paraprak. Meqë rritja e çmimeve ndikon negativisht fuqinë blerëse të konsumatorëve, është me rëndësi të kuptohet sjellja e sektorit bankar për të menaxhuar rrezikun në rritje, si dhe perceptimin e sektorit bankar mbi aftësinë ripaguese të klientëve, rrjedhimisht pritjet për materializimin e mundshëm të rrezikut kreditor.

Në këtë aspekt, sektori bankar veçse ka filluar të marr masa për menaxhimin e rrezikut në rritje nga rritja e çmimeve. Një pjesë e madhe e bankave deklaruan që kanë aplikuar monitorim më vigjilent të performancës financiare të klientëve dhe janë më konservativ gjatë vlerësimit të kapaciteteve të shlyerjes së borxhit, veçanërisht kundrejt ekonomive familjare. Gjithashtu, bankat kanë rritur

normën e interesit në kredi, për më tepër një nga bankat aplikon ndryshime në strukturën e normave të interesit të kredisë në bazë të statusit të klientit, pra shkurtimin e periudhës me normë fikse kundrejt zgjatjes së periudhës me normë të ndryshueshme (variabile) të interesit. Ndër masa tjera të ndërmarra, hyn ndarja më konzervative e provizioneve, si provizionimi i cili targeton segmente të caktuara të klientëve me paga më të ulëta, tutje ulje e raportit të borxhit ndaj të ardhurave për klientët me nivel të caktuar të të ardhurave, rritja e kriterëve të të ardhurave të pranueshme për miratimin e kredisë, si dhe diversifikim i portfolios kreditorë për të ulur ekspozimin në sektorët më të prekur. Të pyetur për sektorët më të prekur, bankat deklaruan se pothuajse të gjithë sektorët janë prekur nga rritja e çmimeve. Megjithatë, ata theksuan se sektori i ndërtimit, prodhimit dhe transportit janë sektorët më të cenueshëm. Sektori i ekonomive familjare, u përmend gjithashtu si një nga sektorët më të prekur.

Pjesa më e madhe e bankave deklaruan se ndikimi i inflacionit nuk u reflektua në dinamikat e kërkesës për kredi deri në këtë tremujor. Në linjë me këtë, dinamikat në kreditim i mbështetën pritjet e bankave, të cilat nuk ishin të bazuara në rritjen e çmimeve, mirëpo në dinamikat e zakonshme të sezonalitetit të ekonomisë. Megjithatë, nga përgjigjet e bankave vërehet më shumë pasiguri sa i përket pritjeve për kërkesën për kredi, ku një pjesë e bankave presin kërkesë të shtuar, e njëkohësisht ka banka që presin shtyrje të kërkesës për kredi deri në një periudhë të stabilizimit të çmimeve në treg. Për më tepër, duke pasur parasysh ndikimin e rritjeve të çmimeve në të hyrat e klientëve, e rrjedhimisht në depozita, një numër i bankave zhvendosën fokusin nga zgjerimi i aktivitetit kreditor në sigurimin e financimit përmes depozitave. Një zhvillim i vërejtur edhe nga rritja e normave të interesit të depozitave dhe fushatat e përshtatura posaçërisht për tërheqjen e depozitave.

Aspekt tjetër i mbuluar nga pyetjet shtesë ishte edhe ndikimi i rritjes së çmimeve në aftësinë e ripagimit të kredive nga klientët e rrjedhimisht rritja e rrezikut kreditor. Sentimenti i bankave nga përgjigjet e marra tregon se bankat presin që rreziku kreditor në rritje, i amplifikuar edhe nga kriza energjetike e pritur, të fillojë të materializohet në tremujorin e parë të vitit 2023 dhe të përkeqësohet tutje në gjysmën e dytë të vitit.

Rritja e vazhdueshme e çmimeve në treg ndikon në zvogëlimin e të hyrave të disponueshme, gjë që reflektohet në kufizimin e mjeteve që mbahen në sektorin bankar. Rrjedhimisht, për të siguruar financimin nga depozitat bankat kanë filluar dhe pritjet të vazhdojnë me ofertë të favorshme për tërheqjen e depozitave, kryesisht përmes rritjes së normave të interesit në depozita, e cila përkthehet në rritje të kostos së financimit të bankave. Përveç kësaj, rritja e normave të interesit nga BQE, si dhe autoritetet tjera monetare, po ashtu ndikoi koston e financimit, duke rritur kostot e financimit nga bankat amë dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Në këtë aspekt, pjesa më e madhe e bankave deklaruan rritje të kostove të financimit, duke sinjalizuar kështu një luhajtje në performancën e tyre financiare, pasi kostot e rritura nuk mund të transmetohen në tërësi te klientët për shkak të presioneve të konkurrencës dhe ndjeshmërisë së klientëve ndaj normave të larta të interesit. Vlen të veçohet, deklarimi nga një bankë, kostot e së cilës u rritën 30 përqind. Ndërsa, vetëm dy banka deklaruan se kostoja e financimit të tyre nuk ka ndryshuar.

Pritjet për një krizë energjetike, të shkaktuar nga pasiguria e sigurimit të energjisë elektrike dhe rritja e çmimeve të energjisë, vërehen tashmë në përgjigjet e bankave. Bankat deklaruan se të gjithë sektorët pritjet të preken duke marr parasysh implikimin e këtij inputi në të gjithë sektorët. Megjithatë, ata theksuan se sektori i prodhimit, ndërtimit, furnizimit me energji elektrike, si dhe ekonomitë familjare janë sektorët më të ndjeshëm. Si masa preventive, bankat identifikuan klientët më të ndjeshëm dhe i ofruan atyre mbështetje bazuar në nevojat e tyre, kryesisht nëpërmjet ristrukturimeve të mundshme, financimit të burimeve alternative të energjisë dhe sigurimit afatshkurtër të likuiditetit. Për më tepër, ata do të monitorojnë më nga afër dhe do të marrin vendime për financime të reja, veçanërisht nga sektorët e prekur, në mënyrë më konservative.

Përgjigjet e disagreguara të bankave për ndërmarrjet, sipas sektorëve, tregojnë për kahjen e financimit të ekonomisë dhe dinamikat në sektorë të caktuar. Gjatë tremujorit të tretë 2022, standardet kreditore për të gjithë sektorët ekonomik u shtrënguan. Bazuar në shtrëngimet e standardeve kreditore, sektori i ndërtimtarisë dhe ai i patundshmërive përbëjnë sektorët me ofertën më jo të volitshme. Përgjigjet e pesë bankave për sektorin e ndërtimtarisë (dy banka me rëndësi sistemike, një nga to deklaroi shtrëngim të konsiderueshëm) dhe tre bankave për sektorin e patundshmërive, e prej tyre dy banka me rëndësi sistemike dhe me peshë të lartë në gjithsej kreditimin e sektorit, reflektuan shtrëngime të standardeve kreditore për këta sektor, e që rezultuan në indeks negativ prej 0.37 dhe 0.15, respektivisht. Njëkohësisht, edhe kushtet dhe rregullat u shtrënguan për të gjithë sektorët ekonomik, e sidomos për sektorin e ndërtimtarisë me indeks negativ prej 0.29, dhe për sektorët e prodhimit, shërbimeve dhe patundshmërive komerciale me indeks negativ prej 0.19. Kërkesa për kredi shënoi rënie nga tre prej sektorëve ekonomik dhe rritje të ulët nga dy sektorët tjerë. Sektorët me kërkesën të zvogëluar për financim ishin ai i prodhimit me indeks negativ prej 0.15, pasuar nga sektori ndërtimtarisë dhe i shërbimeve me indeks negativ të ulët prej 0.06 dhe 0.07, respektivisht. Përderisa, sektori i patundshmërive rezultoi me indeks pozitiv të ulët 0.10, i ndikuar nga përgjigja e dy bankave sistemike, ku prej tyre një bankë me peshë të madhe në sektor deklaroi rritje të konsiderueshme të kërkesës duke neutralizuar kështu përgjigjet e dy bankave tjera po ashtu me rëndësi sistemike të cilat deklaruan rënie të kërkesës deri në një masë për këtë sektor.

Bazuar në rezultatet e gjeneruara, gjatë TM4 2022 bankat pritet të aplikojnë ofertë deri në një masë të shtrënguar për sektorin e ndërtimtarisë, ndërsa ofertë më të volitshme edhe pse në nivel marginal pritet të ketë për sektorin e shërbimeve, tregtisë dhe prodhimit. Kushtet dhe rregullat pritet të lehtësohen kryesisht për sektorin e prodhimit dhe shërbimeve, ndërsa në nivel marginal pritet të ketë shtrëngime për sektorin e ndërtimtarisë. Në të njëjtën periudhë, kërkesa për kredi pritet të ketë rritje për të gjithë sektorët. Konkretisht, kërkesa për financim nga sektorët e tregtisë (indeks pozitiv prej 0.28), shërbimeve dhe prodhimtarisë (indeks pozitiv prej 0.21) pritet të kenë rritjen më të lartë në TM4 2022.

Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikën më të mira rajonale dhe më gjerë, BQK ankton institucionet financiare në vend, duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikën më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikën e inflacionit. Si rezultat, nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKB është pasuruar edhe me pyetje shtesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet në çmime në vend, duke ndihmuar kështu dhe plotësuar analizat tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Në pyetësin e fundit, përveç deklarimit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin aktual, pyetësi adreson edhe pritjet e bankave për vitin 2022 në përgjithësi si dhe për tremujorin e parë të vitit 2023. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivitetit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet të cilat e kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agjentëve ekonomik lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivit. Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se shërbejnë si input i rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore të shoqëruara edhe me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, fillimisht vlerësimet për tremujorin aktual si dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm dhe vitin aktual në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.

Përmbledhja e rezultateve

Bazuar në anketën e realizuar në tetor të vitit 2022, bankat kanë vlerësuar nivel më të lartë të inflacionit në tremujorin e katërt të vitit 2022 krahasuar me tremujorin paraprak, ndërkohë që presin një nivel më të ulët të inflacionit në tremujorin e parë të vitit 2023. Për vitin 2022, bankat presin se niveli i inflacionit do të jetë 11.0 përqind, nga 3.4 përqind sa ishte në vitin 2021.

Të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për tremujorin e tretë të vitit 2022 sugjerojnë se norma mesatare vjetore e inflacionit ishte rreth 13.3 përqind. Për tremujorin e katërt të vitit 2022, bankat presin se norma mesatare e inflacionit do të jetë 11.3 përqind. Shumica e bankave (8 sosh) presin që inflacioni do të jetë mbi 10 përqind, ndërsa bankat tjera (2 sosh) presin se inflacioni do të jetë nën këtë nivel.

Tabela 2. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM4 2022	TM1 2023	2022
1	10.0%	8.0%	10.0%
2	14.5%	13.2%	14.0%
3	4.2%	5.3%	7.0%
4	12.1%	5.5%	11.6%
5	13.0%	5.0%	13.0%
6	11.0%	10.2%	11.2%
7	12.0%	13.0%	12.0%
8	11.1%	7.6%	11.4%
9	12.7%	11.0%	7.0%
10	12.0%	13.0%	13.0%
Mesatarja	11.3%	9.2%	11.0%


Burimi: Bankat komerciale dhe kalkulimet e BQK-së.

Siç ilustron nga figura 8, shpërndarjet e raportuara të probabilitetit tregojnë për një siguri relativisht të lartë në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit, pasi shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur.

Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë përmendur faktorët e mundshëm, të brendshëm dhe të jashtëm, që kanë ndikuar në rritjen e shkallës së inflacionit:

- ✓ Lufta në Ukrainë është arsyeja kryesore e rritjes së çmimeve. Për ekonominë globale, Rusia dhe Ukraina janë furnizues të rëndësishëm të lëndëve të para si energjia, metalet dhe produktet bujqësore dhe lufta ka vënë në pikëpyetje furnizimin e këtyre burimeve dhe ka përshpejtuar rritjen e çmimeve. Për shkak të pasigurisë së rreziqeve gjeopolitike, çmimet e mallrave mund të rriten më tej dhe kjo mund të përkthehet në kosto më të larta operative të prodhimit, të cilat përkthehen në çmime më të larta dhe pritshmëri më të larta inflacioniste;

Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM4 2022 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komercial dhe kalkulimet e BQK-së.

- ✓ Rritja e çmimeve të derivateve të naftës por edhe të kategorive të tjera janë reflektuar në rritjen e përgjithshme të çmimeve. Vendimi i vendeve të OPEC-ut për shkurtimin e prodhimit të derivateve për 2% si dhe pritjet për rritje të çmimeve të energjisë si rezultat i konsumit dimëror mund të kenë ndikim në rritje të mëtejme të inflacionit;
- ✓ Zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si dhe varësia e madhe e ekonomisë së vendit nga importet si rezultat i kapaciteteve të ulëta prodhuese kanë ndikuar në rritjen e çmimeve;
- ✓ Kufizimet në ofertë si rezultat i pengesave të krijuara në zinxhirët e furnizimit si pasojë e pandemisë Covid-19, ku shumë kompani po e kanë të vështirë të gjejnë lëndë të para për të prodhuar produktet e tyre, ka ndikuar po ashtu në rritjen e çmimeve. Për më tepër, rritja e koston të transportit detar ka ndikuar në rritjen e çmimeve, sidomos të vajit, derivateve, materialit ndërtimorë, etj.

Duke pasur parasysh dinamikat me të cilat po karakterizohen çmimet në vend, ku muajve të fundit po vërehet një rritje më e ngadalësuar e çmimeve, mendojmë se pritjet e bankave janë realiste.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org